

# DEKLARIMI INDIVIDUAL I TË ARDHURAVE

Të gjithë individët rezidentë në Republikën e Shqipërisë, për të gjitha të ardhurat e krijuara gjatë periudhës tatimore (vit kalendarik), pavarësisht nga burimi i këtyre të ardhurave, i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale. Të gjithë individët jorezidentë, i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale në Shqipëri, për burimet e të ardhurave të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës tatimore.

## Individi rezident

Individi konsiderohet rezident në Republikën e Shqipërisë për qëllime tatimore, kur ka një banesë të përhershme, ka familjen, pra ka interesa jetësorë dhe ekonomikë në Shqipëri (vendi i interesave jetikë), pavarësisht se mund të punojë në periudhatë ndryshme jashtë vendit apo mund të ketë nënshtetësi tëhuaj.

Konsiderohet rezident shqiptar për qëllime tatimore, individii cili qëndron në Shqipëri gjatë një viti tatimor, në vazhdimose me ndërprerje, në total, më tepër se 183 ditë, pavarësisht nga shtetësia apo vendi ku ka interesat jetike. Në llogaritjen ekohës së qëndrimit në Shqipëri përfshihen ditët e prezencës fizike, pra jo vetëm ditët e punës, por edhe ditët e mbërritjes, largimit, pushimet.

Funksionarët konsullorë, diplomatikë ose të ngjashëm, të caktuar me punë nga shteti në ambasada, konsullata apo në organizma ndërkombëtarë jashtë vendit, konsiderohen gjithashtu rezidentë tatimorë shqiptarë edhe pse jetojnë me vite jashtë Shqipërisë.

## Individi jorezident

Konsiderohet individ jorezident në Republikën e Shqipërisë, personi i cili nuk plotëson njërin ose të dyja kriteret e sipërpërmendura (kriterin e vendbanimit dhe kriterin e kohës së qëndrimit).

## Detyrimi për të deklaruar

Individi rezident shqiptar, që realizon të ardhura bruto vjetore me burim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në shumën 2.000.000 lekë, mbi këtë shumë, kadetyrimin të plotësojë dhe dorëzojë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave brenda datës 30 Prill të vitit që pason vitin e mbyllur kalendarik.

Individi jorezident, që realizon të ardhura bruto vjetore meburim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në shumën

2.000.000 lekë, mbi këtë shumë, duhet të plotësojë dhe dorëzojë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave brenda datës 30 Prill të vitit që pason vitin e mbyllur kalendarik.

Detyrimin për të plotësuar DIVA e kanë gjithashtu, edhe individët rezidentë apo jo rezidentë, të cilët kanë qenë të punësuar në më shumë se 1 (një) punëdhënës, pavarësisht se totali i të ardhurave të tyre gjatë këtij viti kalendarik është nën 2.000.000 (dy milionë) lekë. Ky parashikim zbatohet për individët të cilët kanë përfutur të ardhura nga punësimi nga më shumë se një punëdhënës duke filluar nga 1 janari 2020.

## E drejta për të deklaruar pa qenë i detyruar nga ligji

Individët rezidentë shqiptarë të cilët nuk janë subjekt iplotësimit dhe dorëzimit të deklaratës individuale vjetore,

por që realizojnë të ardhura vjetore bruto jo më shumë se 1050 000 lekë, mund të plotësojnë dhe dorëzojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave nëse duan të përfutnë ngazbritja e shpenzime të kryera gjatë vitit kalendarik fiskal.

## Të ardhurat e tatueshme

Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, konsiderohet të ardhura të tatueshme, të ardhurat personale të mëposhtme: Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrdhënit e punësimit për individët

2. Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare;
3. Të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfutur nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emëtuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji;
4. Të ardhurat që rrjedhin nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale;
5. Të ardhurat nga enfitheoza, huaja dhe qiratë, me përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar;
6. Të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

7. Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.
8. Të ardhurat e individëve nga lojërat e fati dhe kazinotë.
9. Të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksoiner zotëron dhe ja shet një personi tjetër;
10. Të ardhurat në formë monetare për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, që nuk janë të tatuara më parë, ndërkohë që kanë qenë objekt tatimi dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e këtyre të ardhurave. Procedurat përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Financave."

## Shpenzimet që mund të zbriten

Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të këtyre individëve që plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, janë shpenzime të zbritshme shpenzimet e mëposhtme:

- a) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete, për fëmijët dhe personat në kujdestari;
- b) shpenzimet për mjekim, për vete, për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëmshëndetësor.

## Afati dhe mënyra e deklarimit

Deklarata vjetore e të ardhurave individuale, duhet të dorëzohet brenda datës 30 Prill të vitit që pason vitin e mbyllur kalendarik. Deklarimi bëhet në rrugë elektronike. Çdo individ rezident shqiptar, të cilit i lind detyrimi për të deklaruar, por që nuk është i regjistruar në e-Filing, duhet të regjistrohet duke ndjekur hapat si vijon:

- Hyn në faqen zyrtare të internetit të DPT-së në adresën: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)
  - Klikon në menunë e-Shërbime", zgjedh në të djathtë nën-menunë "Për Individët"
  - Klikon në linkun "kliko këtu", në paragrafin e dytë
  - Në ekran do të shfaqet tabela e të dhënave për tu plotësuar për individin.
- Individët jorezidentë, duhet të drejtohen në zyrën më të afërttatimore për t'u regjistruar

**Pagesa e detyrimit për tatimin mbi të ardhura personale** Nëse nga plotësimi i deklaratës vjetore rezultojnë se individiduhet të paguajë tatim, bazuar në rubrikën "Totali për t'u paguar", të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave, individ i dorëzon në bankë formularin "Urdhërpaguesë e tatimit mbi të ardhurat individuale", e cila gjenerohet nga sistemi informatik dhe bën pagesën e tatimit jo më vonë se data 30 Prill e vitit pasardhës të vitit për të cilin bëhet deklarimi.

## Korrigjimi i deklaratës së dorëzuar më parë

Individi deklarues mund të korrigjojë deklaratën fillestare të tij deri në dy herë, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të deklaratës së parë të plotësuar gabim, pa penalitete.

Në rast të një korrigjimi tjetër, pas atij të dytë, brenda afatit tremujor nga dorëzimi i deklaratës fillestare ndaj individit tatimpagues deklarues zbatohen sanksionet ligjore.

Individi e dorëzon deklaratën e korrigjuar nga llogaria e tij në e-filing në faqen zyrtare të tatimeve online [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al).

## Dokumentacioni justifikues i të ardhurave dhe shpenzimeve

Çdo e ardhur e realizuar dhe shpenzim i kryer, deklaruar në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave, duhet të jetë i provuar me dokumentin ligjor përkatës justifikues. Individi deklarues në rast të një kërkesë nga Administrata Tatimore, ka detyrimin të paraqesë, dokumentacionin përkatës justifikues.

Për më shumë informacion klikoni në [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), drejtoheni në sportelet e shërbimit ndaj tatimpaguesve në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, ose telefononi në numrin pa pagesë

**0800 00 02**

të Qendrës së Thirrjeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.